



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2958/ 10 prot.

Datë 18/11/2025

V E N D I M
Nr. 1708/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18/11/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1618/2025, datë 07.11.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-64919-10-14-2025, me objekt “KUB Vlorë (Kanalizimet e Ujrave të Bardha) – Rindërtimi, ridimensionimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë përgjatë rrugës Transballkanike, sipas loteve: nga rruga e Skelës deri te rruga Hasan Kushta (Albano dhe Romina), rruga Odise Grillo, si dhe kolektori nga dalja e rrugës Transballkanike deri në shkarkimin në Kanalin e Fushës”, me fond limit 232,867,500 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Ankimues: Operatori ekonomik “METEO” SHPK me NIPT: L26310801C dhe me adresë: Pishaj, Cekin, Rruga Gramsh Elbasan..

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu”, Vlorë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 07.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1618/2025, datë 07.11.2025, ku vendosi:

1. [...]Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “METEO” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-64919-10-14-2025, me objekt “KUB Vlorë (Kanalizimet e Ujrave të Bardha) – Rindërtimi, ridimensionimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë përgjatë rrugës Transballkanike, sipas loteve: nga rruga e Skelës deri te rruga Hasan Kushta (Albano dhe Romina), rruga Odise Grillo, si dhe kolektori nga dalja e rrugës Transballkanike deri në shkarkimin në Kanalin e Fushës”, me fond limit 232,867,500 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “METEO” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-64919-10-14-2025, me objekt “KUB Vlorë (Kanalizimet e Ujrave të Bardha) – Rindërtimi, ridimensionimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë përgjatë rrugës Transballkanike, sipas loteve: nga rruga e Skelës deri te rruga Hasan Kushta (Albano dhe Romina), rruga Odise Grillo, si dhe kolektori nga dalja e rrugës Transballkanike deri në shkarkimin në Kanalin e Fushës”, me fond limit 232,867,500 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “METEO” ShPK.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 18904/1 prot., datë 12.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2958/7 prot., datë 18.11.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1618/2025, datë 07.11.2025, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1618/2025, datë 07.11.2025, si dhe ka publikuar shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit në përputhje me vendimin Nr. 1618/2025, datë 07.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-64919-10-14-2025, me objekt “*KUB Vlorë (Kanalizimet e Ujrave të Bardha) – Rindërtimi, ridimensionimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë përgjatë rrugës Transballkanike, sipas loteve: nga rruga e Skelës deri te rruga Hasan Kushta (Albano dhe Romina), rruga Odise Grillo, si dhe kolektori nga dalja e rrugës Transballkanike deri në shkarkimin në Kanalin e Fushës*”, me fond limit 232,867,500 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 18904/1 prot., datë 12.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2958/7 prot., datë 18.11.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1618/2025, datë 07.11.2025, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1618/2025, datë 07.11.2025, si dhe ka publikuar shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit në përputhje me vendimin Nr. 1618/2025, datë 07.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-64919-10-14-2025, me objekt “*KUB Vlorë (Kanalizimet e Ujrave të Bardha) – Rindërtimi, ridimensionimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë përgjatë rrugës Transballkanike, sipas loteve: nga rruga e Skelës deri te rruga Hasan Kushta (Albano dhe Romina), rruga Odise Grillo, si dhe kolektori nga dalja e rrugës Transballkanike deri në shkarkimin në Kanalin e Fushës*”, me fond limit 232,867,500 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionit bashkëlidhur saj, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentat e tenderit sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 1618/2025, datë 07.11.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojcën përkatëse për modifikimin e dokumentave të tenderit.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-64919-10-14-2025, me objekt “KUB Vlorë (Kanalizimet e Ujrave të Bardha) – Rindërtimi, ridimensionimi dhe rehabilitimi i kolektorëve kryesorë përgjatë rrugës Transballkanike, sipas loteve: nga rruga e Skelës deri te rruga Hasan Kushta (Albano dhe Romina), rruga Odise Grillo, si dhe kolektori nga dalja e rrugës Transballkanike deri në shkarkimin në Kanalin e Fushës”, me fond limit 232,867,500 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë..
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

